



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”

Formulari i aplikimit për përjashtim nga tarifa vjetore e shkollimit, Viti akademik  
2023-2024

Në zbatim të VKM nr. 269, datë 29.03.2017 “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit”, VKM-së nr. 40, datë 23.01.2019 dhe VKM-së nr. 251, datë 27.03.2020 “Për disa ndryshime në VKM-në nr. 269, datë 29.03.2017”.

Studentët që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit duhet të ndjekin:

- ✓ Program të ciklit të parë të studimeve
- ✓ Program të integruar të studimeve
- ✓ Program të studimeve profesionale

Emër Atësi Mbiemër i/e studentit: \_\_\_\_\_

Nr. ID \_\_\_\_\_ Fakulteti: \_\_\_\_\_

Program Studimi: \_\_\_\_\_ Viti i studimeve: \_\_\_\_\_

Nr. Kontakti: \_\_\_\_\_ Adresë email: \_\_\_\_\_

**Kriteri 1:** Studentët, familjet e të cilëve trajtohen me ndihmë ekonomike;

<b>Dokumentacioni shoqërues i domosdoshëm:</b>
✓ Vërtetim origjinal për trajtimin me ndihmë ekonomike nga Njësia e Qeverisjes Vendore (vërtetimi duhet të jetë i tre muajve të fundit) + vlera (masa) e plotë/pjesëshme
✓ Çertifikatë familjare nga sistemi e-albania e tre muajve të fundit
✓ Fotokopje e kartës së identitetit të studentit

**Kriteri 2:** Bashkëshortët, të cilët kanë fëmijë dhe janë të dy studentë;

<b>Dokumentacioni shoqërues i domosdoshëm:</b>
✓ Vërtetim studenti për bashkëshortin/en e aplikantit
✓ Çertifikatë familjare nga sistemi e-albania e tre muajve të fundit
✓ Fotokopje e kartës së identitetit të studentit

**Kriteri 3:** Studentët me aftësi të kufizuara, të vërtetuar me vendim të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë, përfitues të pagesës së aftësisë së kufizuar;

<b>Dokumentacioni shoqërues i domosdoshëm:</b>
✓ Vendimi i KMCAP-së i studentit origjinal ose i noterizuar
✓ Çertifikatë familjare nga sistemi e-albania e tre muajve të fundit
✓ Fotokopje e kartës së identitetit të studentit

**Kriteri 4:** Studentët, të cilët i kanë të paktën njërin prind me aftësi të kufizuar, të vërtetuar me vendim të KMCAP-së përfitues të pagesës së aftësisë së kufizuar;

<b>Dokumentacioni shoqërues i domosdoshëm:</b>
✓ Vendimi i KMCAP-së origjinal ose i noterizuar i prindit
✓ Çertifikatë familjare nga sistemi e-albania e tre muajve të fundit
✓ Fotokopje e kartës së identitetit të studentit.

**Kriteri 5:** Studentët, të cilët i kanë të dy prindërit pensionistë ose njërin prind pensionist dhe prindi tjetër nuk jeton;

<b>Dokumentacioni shoqërues i domosdoshëm:</b>
✓ Vërtetim pensioni për të dy prindërit ose vërtetim pensioni për prindin pensionist dhe certifikatën e vdekjes së prindit tjetër
✓ Çertifikatë familjare nga sistemi e-albania e tre muajve të fundit
✓ Fotokopje e kartës së identitetit të studentit.

**Kriteri 6:** Studentët, të tretët në radhën e fëmijëve e lart, të cilët vijnë nga familje me tre fëmijë e më shumë, nga të cilët dy të parët janë studentë në institucionet publike të arsimit të lartë;

<b>Dokumentacioni shoqërues i domosdoshëm:</b>
✓ Vërtetim studenti i motrave apo vëllezërve studentë lëshuar nga institucionet publike të arsimit të lartë
✓ Çertifikatë familjare nga sistemi e-albania e tre muajve të fundit
✓ Fotokopje e kartës së identitetit të studentit

**Kriteri 7:** Studentët, që kanë përfituar statusin e jetimit, deri në moshën 25 vjeç;

<b>Dokumentacioni shoqërues i domosdoshëm:</b>
✓ Kopje e noterizuar e librezës për përfitimin e statusit të jetimit, lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror
✓ Fotokopje e kartës së identitetit të studentit
✓ Çertifikatë familjare nga sistemi e-albania e tre muajve të fundit
✓ Certifikatat e vdekjes së prindërve

**Kriteri 8:** Studentët deri në moshën 25 vjeç, që kanë humbur kujdestarinë prindërore me vendim gjykatë të formës së prerë;

<b>Dokumentacioni shoqërues i domosdoshëm:</b>
✓ Kopje e noterizuar e vendimit të Gjykatës të formës së prerë për humbjen e kujdestarisë prindërore.
✓ Fotokopje e kartës së identitetit të studentit
✓ Çertifikatë familjare nga sistemi e-albania e tre muajve të fundit

**Kriteri 9:** Studentët, të cilët deri në moshën 25 vjeç, janë identifikuar si viktime të trafikut të qenieve njerëzore dhe kanë përfituar statusin ligjor për trajtim si viktime të trafikut të qenieve njerëzore;

<b>Dokumentacioni shoqërues i domosdoshëm:</b>
✓ Dokument origjinal që vërteton statusin ligjor për trajtim si viktime të trafikut të qenieve njerëzore lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror
✓ Fotokopje e kartës së identitetit të studentit
✓ Çertifikatë familjare nga sistemi e-albania e tre muajve të fundit

**Kriteri 10:** Studentët, të cilët janë fëmijë të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ Shtetëror dhe të Policisë së Burgjeve, që kanë humbur jetën në krye dhe për shkak të detyrës, të konfirmuar nga ministria përgjegjëse;

<b>Dokumentacioni shoqërues i domosdoshëm:</b>
✓ Dokument origjinal/ose i noterizuar, që vërteton se studenti është fëmijë i punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ Shtetëror dhe të Policisë së Burgjeve, që kanë humbur jetën në krye dhe për shkak të detyrës, të konfirmuar nga ministria përgjegjëse për punët e brendshme dhe ajo mbrojtjes
✓ Fotokopje e kartës së identitetit të studentit
✓ Çertifikatë familjare nga sistemi e-albania e tre muajve të fundit

**Kriteri 11:** Studentët romë dhe egjiptianë, të cilët do të identifikohen nëpërmjet vetëdeklarimit

<b>Dokumentacioni shoqërues i domosdoshëm:</b>
✓ Vetëdeklarimi nga studenti që i përket komunitetit rom dhe egjiptian
✓ Fotokopje e kartës së identitetit të studentit
✓ Çertifikatë familjare nga sistemi e-albania e tre muajve të fundit

**Kriteri 12:** Studentët, fëmijë të ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist ose fëmijë me prindër të dënuar politikë me heqje lirie

<b>Dokumentacioni shoqërues i domosdoshëm:</b>
✓ Vërtetim origjinal nga Institucioni i të Përndjekurve Politikë, që vërteton se studenti ka statusin "Fëmijë të ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë"
✓ Fotokopje e kartës së identitetit të studentit
✓ Çertifikatë familjare nga sistemi e-albania e tre muajve të fundit

**Kriteri 13:** Studentët, të cilë kanë note mesatare 9-10

<b>Dokumentacioni shoqërues i domosdoshëm:</b>
✓ Fotokopje e kartës së identitetit të studentit

**Nuk përfitojnë përjashtimin nga tarifa vjetore e shkollimit në rastin kur:**

- Janë ndarë nga trangu familjar;
- Familjet e tyre ushtrojnë veprimtari private;
- Vazhdojnë studimet në një program të dytë studimi;
- Janë shpallur ngelës sipas rregullores së universitetit dhe humbasin vitin për arsye të rezultateve jokaluese;
- Nuk kanë përfunduar programin e studimit brenda kohëzgjatjes normale të tij, të përcaktuar në aktin e hapjes së programit përkatës të studimit;
- Praktika nuk plotësohet nga studentët shtetas të huaj apo studentë që janë si program i dytë studimi.

Unë \_\_\_\_\_, paraqes kërkesën për përjashtim nga tarifa vjetore e shkollimit për vitin akademik 2023-2024, pasi plotësoj kushtet e përcaktuara nga Vendimet e Këshillit të ministrave 40, datë 23.01.2019 dhe VKM nr. 251, datë 27.03.2020 "Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 269, datë 29.03.2017".

Deklaroj se në të dhënat e paraqitura nga ana ime si dhe dokumentacioni shoqërues që provon plotësimin e njërit prej kriterëve të renditura në vijim të kërkesës time, të nënvizuar me shenjën X përbri kriterit. I gjithë dokumentacioni i paraqitur është dokumentacion zyrtar dhe i marrë nga institucione shtetërore dhe/ose të njohura me ligjë.

Jam në dijeni se deklaramet e rreme nga ana ime në këtë kërkesë, si dhe paraqitja e dokumentave të falsifikuara, përveç përgjegjësive penale, sjellin automatikisht edhe heqjen e së drejtës për të përfituar bursë.

Dokumentat shoqëruese janë origjinale ose kopje të noterizuara.

\_\_\_\_\_  
(Emër Mbiemër Nënshkrimi i aplikuesit)